

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS “BIOLOGJI”



Program orientues

Koordinator:
Mimoza Milo

2024-2025

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML.....	14
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	29
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	30
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	60
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	62
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	70




HYRJE

Roli i mësuesit shtrihet përtej mësimdhënies dhe në veçanti roli i mësuesit të biologjisë është i rëndësishëm për shkak të natyrës sfiduese të kësaj fushe. Ai ndikon në krijimin e një mjedisi pozitiv mësimor, zhvillimin e mendimit kritik dhe nxitjen e motivimit për të mësuar. Mësuesit që përdorin teknika efektive mësimore, të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, arrijnë të maksimizojnë potencialin e çdo nxënësi. Një marrëdhënie e mirë mes mësuesit dhe nxënësit krijon një ndjenjë sigurie dhe përkatësie që rrit motivimin dhe angazhimin në mësim. Mësuesit që janë të aftë të identifikojnë vështirësitë individuale dhe t'u japin mbështetje të personalizuar nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike. Mësuesit shpesh janë shembuj për nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në njohuritë mësimore, por edhe në vlerat dhe sjelljet që ata përvetësojnë.

Biologjia kërkon të menduarit kritik për zgjidhjen e problemeve dhe analizimin e situatave komplekse. Një mësues i aftë mund t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të menduar logjikisht dhe për të zbërthyer problemet në hapa të qartë. Mësuesi duhet të jetë i aftë të përdorë metoda të ndryshme për të shpjeguar konceptet e vështira. Kjo mund të përfshijë përdorimin e mjeteve vizuale, shembujve praktikë, lojërave me role apo aplikimeve në jetën reale që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet abstrakte. Biologjia ndërtohet mbi konceptet e mëparshme. Një mësues i mirë i biologjisë e di se duhet të fillojë nga bazat dhe të krijojë një strukturë logjike për të avancuar me koncepte më të përparuara. Kjo siguron që nxënësit të kenë një themel të fortë dhe të mos ndihen të mbingarkuar. Një mësues i mirë i biologjisë mund të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në fusha të caktuara dhe të japë mbështetje shtesë për ta.

Për tema të vështira mësuesi të krijojë aktivitete dhe sfida që nxisin kureshtjen e nxënësve, duke e lidhur biologjinë me situata praktike nga jeta e përditshme ose me fushat që ata i pëlqejnë. Mësuesi i biologjisë mund të përfitojë nga përdorimi i programeve kompjuterike, aplikacioneve dhe platformave edukative që ndihmojnë nxënësit të praktikojnë konceptet dhe të zgjidhin probleme me ritmin e tyre.



Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së biologjisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së biologjisë në për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, qasjen STEM etj.;
- të tregojë përgjegjëshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e biologjisë në secilin nivel arsimor : *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, modele orësh mësimore për lëndën e biologjisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, modele projektsh kurrikulare për lëndën e biologjisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban: zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të biologjisë;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së biologjisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të biologjisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË BIOLOGJISË”

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të biologjisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të biologjisë); • për zgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e biologjisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	• Korniza Kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT
TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e biologjisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • mbështet nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së biologjisë; • edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së biologjisë; • motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së biologjisë në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së biologjisë në arsimin e mesëm të lartë.

Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e biologjisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor proceset shkencore në mësimdhënien – nxënien e biologjisë; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • zbaton parimet e hartimit të një testi për nxënësit.	• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së biologjisë në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së biologjisë në arsimin e mesëm të lartë. • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, Lënda: BIOLOGJI. • Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP, Lënda: BIOLOGJI.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në BIOLOGJI”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> • prezanton materiale biologjike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, etj.;	• Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e

• përdor platforma online për zhvillimin e koncepteve biologjike si p.sh. platforma interaktive PhET simulation etj. • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në biologji duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së biologjisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website.	platformave online në procesin mësimor, ASCAP. • Udhëzues për mësimin e kombinuar në lëndët e shkencave të natyrës dhe matematikës (për klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët) (modele orësh mësimore, teste dhe veprimtari praktike) ASCAP. • Udhëzimi për vlerësimin ndërkombëtar PISA, ASCAP.
---	---

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i biologjisë:</i> - njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së biologjisë”	
<i>Mësuesi i biologjisë:</i> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e biologjisë në klasat VI-IX dhe X-XII; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve biologjike në klasat VI-IX dhe X-XII; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;	Programe dhe tekste të lëndës së biologjisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

- 
- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none">• dallon ndërvlerësinë e koncepteve biologjike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;• zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat VI-IX dhe X-XII;• përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të biologjisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme. | |
|--|--|

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Model pyetjesh të lëndës “BIOLOGJI”, AMU

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Në përputhje me programin e biologjisë jepen rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës të zbërthyer sipas niveleve të arritjes N2, N3, N4. Cili nga rezultatet NUK është formuluar saktë?

- A) Kupton çfarë është një piramidë e biomasës;
- B) Tregon përmes shembujve se si humbet biomasa midis niveleve të ndryshme trofike;
- C) Llogarit efikasitetin e transferimit të biomasës midis niveleve trofike;
- D) Shpjegon se si ndikon transferimi i biomasës në numrin e organizmave në çdo nivel trofik.

Pyetja 2

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Bazuar në kurrikulën me kompetenca, *situata e të nxënit* që planifikohet në planin ditor të mësuesit:

- A) është e detyruar të planifikohet në çdo orë mësimi;
- B) është pjesë e rezultateve të të nxënit të orës së mësimi;
- C) planifikohet vetëm në planin tremujor të periudhës;
- D) lidhet me metodologjinë dhe me organizimin e orës së mësimi.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetje 3

Gjatë zhvillimit të testit në klasë një mësues gjeti që shumica e nxënësve nuk i janë përgjigjur saktë një pyetjeje konceptuale. Cila nga strategjitë e mëposhtme ndihmon në adresimin më të mirë të problematikës?

- A) Motivimi i nxënësve për të lexuar dhe mësuar më mirë.
- B) Vënia në dijeni e prindërve për të ndihmuar nxënësin gjatë të nxënës në shtëpi.
- C) Përsëritja sërish e shpjegimit të konceptit nga mësuesi.
- D) Përcaktimi i boshllëqeve dhe trajtimi i konceptit në përputhje me kontekstin.

Pyetje 4

Një mësues kërkon të zbatojë strategjinë “zgjidhja e problemit” për të ndihmuar nxënësit që të kuptojnë rëndësinë e riciklimit të mbetjeve. Për të realizuar këtë mësuesi:

- A) në fazën e evokimit ndan nxënësit në grupe dhe u drejton atyre pyetje që kanë të bëjnë me riciklimin e lëndëve.
- B) nxit nxënësit t’i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit për të shkëmbyer ide për metodat më të përparuara për riciklimin e lëndëve.
- C) u kërkon nxënësve nëpërmjet një projekti të zhvillojnë mënyra të riciklimit të lëndëve në shkollë.
- D) i kërkon secilit nxënës të përgatis një material në PPT mbi mënyrat e riciklimit të lëndëve.

Pyetja 5

Sipas teorisë së të nxënës konstruktivist: *“Detyrë e nxënësit nuk është ta pranojë informacionin në mënyrë pasive, duke imituar formulimet dhe përfundimet e të tjerëve, por, në vend të kësaj, të angazhohet vetë në brendësimin dhe riformimin ose shndërrimin e informacionit nëpërmjet ‘shqyrtimit aktiv’.* Cila nga alternativat e mëposhtme mbështet thelbin e kësaj teorie?

- A) Të nxënës nëpërmjet shpërblimit është më i pëlqyeshëm se të nxënës nëpërmjet ndëshkimit;
- B) Të nxënës mbështetet në ndërveprimet e ngrohta miqësore ndërmjet nxënësve dhe mësuesve;
- C) Të nxënës përfshin analizën dhe renditjen me kujdes të nevojave dhe sjelljeve të nxënësve;
- D) Të nxënës fitohet kur nxënësve u sigurohen shanse për të bashkëpunuar dhe reflektuar mbi të nxënës e tyre.

Pyetja 6

Në kuadër të procesit të mësimdhënies dhe të nxënës, zbatimi i praktikave bashkëbiseduese sjell që mësuesi:

- A) të respektojë më shumë interesat e nxënësit;
- B) të jetë më pak tolerant në përkufizimin e proceseve shkencore;
- C) të marrë parasysh njohuritë paraprake të nxënësit;
- D) të bjerë dakord me nxënësin për mënyrën e vlerësimit.

Pyetja 7

Zbatimi i metodologjive mësimore që plotësojnë nevojat e të nxënës efektiv, vë theksin më shumë te:

- A) përfshirja sistematike e nxënësve të talentuar në eksperimente e vëzhgime për njohjen e natyrës;
- B) sigurimi i partneritetit mësues-nxënës në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënës;
- C) shpjegimi i vazhdueshëm i mësuesit për të zhvilluar të kuptuarit maksimal të nxënësit;
- D) vlerësimi i detyrave për të motivuar më shumë nxënësit, pa qenë i nevojshëm argumentimi i saj.

Pyetja 8

Cila nga pyetjet e mëposhtme mund të hetohet më mirë duke përdorur kërkimin shkencor?

- A) Kur mbjellin shumica e njerëzve kopshte me lule?
- B) Çfarë ngjyra lulesh pëlqejnë njerëzit të rriten në kopshtet e tyre?
- C) Sa bimë me lule janë zhdukur gjatë historisë së Tokës?
- D) Si ndikon sasia e dritës së diellit në rritjen e bimëve me lule?

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Komunikimi mes mësuesit dhe nxënësit në klasë nuk ka si qëllim vetëm transmetimin e dijeve por edhe:

- A) krijimin e një klime të qetë e bashkëpunimi.
- B) diskutimin e ideve mes nxënësve.
- C) pranimin e ideve të mësuesit.
- D) një bashkëpunim normal mes mësuesit dhe kolegëve.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Qarko alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) ekzistenc
- B) eksistencë
- C) ekzistencë
- D) ekzistenzë

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucijon arsimor

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Si ndihmojnë antibiotikët në trajtimin e infeksioneve bakteriale? Zgjidhni një nga alternativat e mëposhtme.

- A) Forcojnë sistemin imunitar.
- B) Ata vrasin / pengojnë rritjen e baktereve.
- C) Ulin inflamacionin.
- D) Rritin prodhimin e qelizave të bardha të gjakut.

Pyetja 14

Shumë bimë tokësore ruajnë energjinë në formën e niseshtesë. Kur nevojitet energji, molekulat e niseshtesë mund të shpërbëhen shpejt. Ky reaksion kimik prodhon:

- A) aminoacide
- B) lipide
- C) monosakaride
- D) zinxhirë ARN-je

Pyetja 15

Cili efekt i padëshiruar mund të rezultojë nga përdorimi i tepërt i pesticideve kimike për të kontrolluar insektet në kulturat bujqësore?

- A) Kulturat bujqësore që prodhojnë pesticidet e tyre kimike.
- B) Dëmtuesit e insekteve që kalojnë në një burim tjetër ushqimi.
- C) Kulturat bujqësore që kërkojnë më shumë ujë dhe lëndë ushqyese për të mbijetuar.
- D) Dëmtuesit e insekteve bëhen rezistente ndaj pesticideve të caktuara.

Pyetja 16

Cili proces biologjik është përgjegjës për fryrjen e bukës gjatë pjekjes?

- A) fotosinteza
- B) frymëkëmbimi
- C) fermentimi
- D) mbirja

Pyetja 17

Përthithja e ujit nga rrënjët e bimëve kryhet përmes procesit të:

- A) endocitozës
- B) transplantimit
- C) osmozës
- D) fotosintezës

Pyetja 18

Një burrë dhe një grua që kanë të dy flokë me ngjyrë kafe, kanë tre fëmijë. Dy nga fëmijët e tyre kanë flokë me ngjyrë kafe dhe një fëmijë ka flokë biond. Gjeni që kodon flokët kaf është mbizotërues ndaj gjenit që kodon flokët biondë.

Cili nga pohimet e mëposhtme mbështetet nga informacioni i treguar më sipër?

- A) Është e mundur që asnjëri nga prindërit nuk ka gjen që kodon flokët biondë.
- B) Është e nevojshme që të dy prindërit të kenë gjenin që kodon flokët biondë.
- C) Është e mundur që njëri prind të ketë gjenin që kodon flokët biondë dhe prindi tjetër nuk ka gjen që kodon për flokët biondë.
- D) Është e nevojshme që njëri prind të ketë gjenin që kodon flokët biondë dhe prindi tjetër nuk ka gjen që kodon për flokët biondë.

Pyetja 19

Një nxënës vëren një sasi të madhe gjethe pemësh të rëna në oborrin e shkollës. Cila zgjidhje për pastrimin e gjetheve do të kishte ndikim më pozitiv në mjedis?

- A) Grumbullimi i gjetheve për t'i djegur.
- B) Grumbullimi i gjetheve për t'i kompostuar ato.
- C) Futja e gjetheve në qese plastike për t'i ruajtur.
- D) Futja e gjetheve në kamionë për t'i transportuar në një vend për ti groposur.

Pyetja 20

Cilin proces përdorin kafshët në rrjetën ushqimore për të kthyer energjinë nga ushqimi në ATP?

- A) Frymëmarrjen qelizore
- B) Osmozën
- C) Fotosintezën
- D) Transkriptimin

Pyetja 21

Sëmundja e gripit shkaktohet nga:

- A) bakteret
- B) viruset
- C) kërpudhat
- D) protozoarët

Pyetja 22

Cilat lëngje të sekretuara nga organet e sistemit tretës luajnë rol të rëndësishëm në tretjen e yndyrave?

- A) Lëngu pankreatik, pështyma.
- B) Acidi klorhidrik, mukusi.
- C) Lëngu i tëmthit, lëngu pankreatik.
- D) Pështyma, acidi klorhidrik.

Model pyetjesh në lëndën e “Biologjisë”, AML

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Në programet e shkencave të natyrës janë tri kompetenca të kërkimit shkencor që ndërlidhen midis tyre. Cila nga alternativat e mëposhtme përfaqëson një kompetencë të fushës së shkencave natyrore?

- A) Zhvillimi i qëndrueshëm;
- B) Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës;
- C) Mbarështimi selektiv dhe teknologjia në gjene;
- D) Gjenomi dhe shprehja e gjeneve.

Pyetja 2

Në përputhje me programin e biologjisë jepen rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës të zbërthyer sipas niveleve të arritjes N2, N3, N4. Cili nga rezultatet NUK është formuluar saktë?

- A) Njeh rolin e veshkave në eliminimin e mbetjeve të metabolizmit qelizor;
- B) Përshkruan përmes një skeme ndërtimin e veshkës;
- C) Analizon rolin e veshkave në eliminimin e mbetjeve të metabolizmit qelizor;
- D) Vlerëson ndikimin e kequshqyerjes në shëndetin e veshkave.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetja 3

Cila është procedura më e mirë për të dhënë komente pas zhvillimit të një testi në klasë?

- A) Kthejini nxënësve fletët e testit dhe thuaju të kërkojnë përgjigjen për secilën pyetje.
- B) Jepuni referencat e faqeve dhe udhëzoni nxënësit të kërkojnë përgjigjet.
- C) Kthejuni nxënësve fletët e testit dhe shqyrtoni secilën pyetje.
- D) Jepuni secilit nxënës një vlerësim me fjalë si "Ke punuar mirë" ose "Përpiqu më shumë herën tjetër".

Pyetja 4

Një mësues i shkollës së mesme ka planifikuar që nxënësit në një klasë të kryejnë projekte kërkimore individuale në të cilat secili nxënës do të hetonte dhe raportonte për një temë të zgjedhur vetë. Mësuesi vendos që në vend të kësaj t'i bëjë nxënësit të kryejnë dhe raportojnë për kërkimin e tyre në grupe. Qasja në grup ka të ngjarë të jetë veçanërisht efektive për nxënësit e shkollave të mesme sepse:

- E) rrit efikasitetin e përgjithshëm të të nxënësve dhe ndjenjën e kontributit të nxënësve gjatë projektit.
- F) u mundëson nxënësve që zakonisht arrijnë në nivele të ndryshme të performojnë në një nivel të ngjashëm me atë të bashkëmoshatarëve me arritje të larta në klasë.
- G) merr parasysh interesin e nxënësve për ndërveprimet sociale për të rritur motivimin dhe për të rritur angazhimin në procesin mësimor.
- H) nxit nxënësit të përdorin një larmi më të madhe metodash dhe qasjesh për të ndjekur tema kërkimore më të gjera dhe më komplekse.

Pyetja 5

Para fillimit të një kapitulli të ri, një mësues administron një paratest dhe zbulon se gjysma e nxënësve nuk kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si parakusht për të nxënë njohuritë dhe aftësitë e kapitullit të ri. Çfarë duhet të bëjë mësuesi në këtë rast?

- A) Zhvillon temat e kapitullit të ri sepse të gjithë nxënësit do të duhet të bëjnë një test për materialin e ri brenda 2 javësh.
- B) Ndan klasën në dy grupe dhe zhvillon veprimtari rikuperuese për ata që nuk e kaluan paratestin.
- C) Ju jep nxënësve me arritje të ulëta në paratest detyra shtëpie me shkrim për njohuritë dhe aftësitë që do ju duhen për 2 javët e ardhshme.
- D) Ju paraqet të gjithë nxënësve një video që përfshin njohuritë dhe aftësitë dhe vazhdon me mësimin e ri me të gjithë klasën.

Pyetja 6

Përdorimi i materialeve të riciklueshme (tabela, herbariume, materiale mediatike, etj.) në mësimin e biologjisë respekton:

- A) parime të përgjithshme
- B) parime shkencore
- C) parime didaktike
- D) parime ndërlëndore

Pyetja 7

Cili nga hapat e mëposhtëm NUK i përket shtrimit dhe zgjidhjes së problemit si një mjet për të realizuar procesin e të nxënës?

- A) Përcaktimi dhe përkufizimi i problemit;
- B) Zhvillimi i strategjisë për zgjidhjen e problemit;
- C) Vlerësimi i zgjidhjes së arritur;
- D) Krijimi i një miniprojekti shkencor.

Pyetja 8

Për punën e laboratorit me temë “Funksioni i enzimave” përcaktoni cili nga rezultatet mëposhtme të të nxënës lidhet më mirë me temën.

- A) Nxënësi/ja përshkruan çfarë janë enzimët dhe cili është roli i tyre në jetën tonë;
- B) Nxënësi/ja vizaton mekanizmin e veprimit të kompleksit substrat-enzimë;
- C) Nxënësi/ja vëzhgon nëpërmjet eksperimenteve rolin e enzimave si katalizator biologjik;
- D) Nxënësi/ja analizon rolin e temperaturës, pH dhe përqendrimit në aktivitetin enzimatik.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm;
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh;
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm;
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

Pyetja 10

Cila nga thëniet e mëposhtme përshkruan më mirë “gjithëpërfshirjen”?

- A) Është besimi se nxënësit duhet të veçohen sipas aftësive të tyre.
- B) Është besimi se disa nxënës nuk mund të mësojnë.
- C) Është filozofia që të gjithë nxënësit kanë të drejtë të marrin arsim të barabartë në një sistem arsimor.
- D) Është filozofia që nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë për shkolla speciale.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Këshilli Kombëtar i Prindërve
- B) këshilli kombëtar i prindërve
- C) Këshilli kombëtar i prindërve
- D) Këshilli Kombëtar i prindërve

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Portofoli profesional i mësuesit
- B) Portofoli profesjonal i mësuesit
- C) Portofoli profesional i mësuesit
- D) Portofoli profesijonal i mësuesit

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Një uragan përfshiu një ishull të vogël të Karaibeve, duke vrarë 50 për qind të llojeve barngrënëse në ishull. Cili nga alternativat e mëposhtme tregon rezultatin/pasojën e menjëhershme?

- A) Reduktim i biodiversitetit.
- B) Përsheptim i ciklit të karbonit.
- C) Një rritje në popullatat e grabitqarëve.
- D) Një rënie në popullatat dekompozuese.

Pyetja 14

Një familje adopton një qen nga streha lokale e kafshëve. Familja nuk e njeh racën e qenit. Për të ndihmuar në përcaktimin e racës, familja krahason tiparet e qenit me tiparet e racave të njohura të qenve. Familja arrin në përfundimin se prindërit e qenit ishin nga dy raca të ndryshme. Cilin koncept shkencor ka përdorur më shumë familja për të nxjerrë këtë përfundim?

- A) Përzgjedhja natyrore
- B) Ligji i parë i Njutonit
- C) Gjenetika Mendeliane
- D) Teoria e evolucionit

Pyetja 15

Ndonjëherë njerëzit duhet të pastrojnë kullotat për të rritur të korrat. Kjo praktikë shpesh zëvendëson llojet e bimëve vendase që kanë rrënjë të thella në tokë me kultura bimësh me rrënjë të cekëta. Përveç kësaj, shumica e bimëve bujqësore duhet të korren dhe rimbillen çdo vit, duke e lënë tokën të zhveshur për një pjesë të vitit. Çfarë efekti do të kishte në zonë zëvendësimi i tokave me bar me tokat bujqësore?

- A) rritja e erozionit të tokës
- B) rritja e lëndëve ushqyese në tokë
- C) rritje e diversitetit të llojeve
- D) rritja e ujit në dispozicion të bimëve

Pyetja 16

Mënyra kryesore e transportit të gazit dyoksid karboni në gjak është:

- A) përmes joneve bikarbonat.
- B) me hemoglobinën.
- C) duke u tretur në plazmën e gjakut.
- D) përmes procesit të difuzionit.

Pyetja 17

Cilat lëndë ushqyese të tretura lëvizin nga vilet në enët limfatike:

- A) glukozja dhe vitaminat.
- B) glukozja dhe aminoacidet.
- C) aminoacidet dhe acidet yndyrore.
- D) acidet yndyrore dhe gliceroli.

Pyetja 18

Reaksioni specifik imunologjik që shkakton dukurinë e aglutinimit ndodh kur:

- A) grupi A i gjakut i dhuron gjak grupit AB të gjakut;
- B) grupi AB i gjakut i dhuron gjak grupit A të gjakut;
- C) grupi O i dhuron gjak grupit B të gjakut;
- D) grupi A i dhuron gjak grupit A të gjakut.

Pyetja 19

Në kryqëzimin $AaBb \times aabb$, gjenet janë të pavarur. Raporti që pritet në F_1 është:

- A) 1:1:1:1
- B) 9:3:3:1
- C) 3:1
- D) 1:1

Pyetja 20


Kalcitonina ul nivelin e kalciumit në gjak duke:

- A) frenuar depozitim të kalciumit në kocka.
- B) frenuar përthithjen e kalciumit në zorrë dhe në gypat e nefronit.
- C) nxitur ripërthithjen e kalciumit nga gypat e nefronit.
- D) rritur sasinë e kalciumit të përthithur nga vilet e zorrëve të holla.

Pyetja 21

Rendimenti i kalimit të lëndëve ulet në mënyrë të menjëhershme kur sinteza e ATP në qelizë bllokohet. Në këtë rast sistemi i transportit është:

- A) transport pasiv;
- B) transport aktiv;
- C) difuzion;
- D) shpërhapje e lehtësuar.



Pyetja 22

Në një ADN janë gjetur 25 timina dhe 10 guanina. Numri i lidhjeve hidrogjenore që formohen midis dy vargjeve të saj është:

- A) 35
- B) 50
- C) 60
- D) 80

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënës dhe përshtaten me stilet e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenëdruar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxëni efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënës që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore për lëndën e biologjisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxëniet, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

A. Model ore mësimore 1 në lëndën e “Biologjisë” AMU

Fusha: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Klasa: VIII

Tematika: Qarkullimi

Situata e të nxëniet: Zemra e një futbollisti

Tema mësimore: Dieta dhe veprimtaria fizike

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematika


Rezultatet e të nxëniet për temën mësimore.

Nxënësi:

- Bën parashikime si duhet të jetë dieta ushqimore për një zemër të shëndetshme dhe i shqyrton ato me anë të provave.
- Interpreton të dhënat duke nxjerrë përfundime për lidhjen ndërmjet ritmit të zemrës dhe sasisë së oksigjenit në gjak.

Burimet: Libri i nxënësit; fletore pune; mjete shkrimi; fletë të bardha dhe me ngjyra për skicimin e proceseve dhe koncepteve; tabela ilustruese; flipchart; lapustila; simulime; CD interaktive; fletë pune; laptop; shkumësa me ngjyra etj.

Koncepte kyç: Dietë e ekuilibruar, vena, arterie, sforcim i zemrës, kapilarë, jetë sedentare, veprimtari fizike etj.



Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e orës mësimore:

(PNP) Parashikimi -Ndërtimi i njohurive- Përforcimi

Teknikat/strategjitë e orës mësimore: Grupet bashkëpunuese, punë në grupe, simulim.


Parashikimi: *Grupet bashkëpunuese-*. Formohen grupe me nga 4 nxënës. Shpërndahen fleta pune në çdo grup. ¹Fleta e punës përmban 4 detyra të ndryshme. Secili nxënës në grup duhet të zgjidh një detyrë. Nxënësit që kanë të njëjtën pyetje nga grupe të ndryshme ndërveprojnë, miratojnë ose plotësojnë përgjigjen e saktë.

Ndërtimi i njohurive-Simulimi- Nxënësit klikojnë link-un:

<https://phet.colorado.edu/sims/cheerpi/eating-and-exercise/latest/eating-and-exercise.html?simulation=eating-and-exercise>

Pasi nxënësit futen në mjedisin e simulimit, udhëzohen nga mësuesi se si duhet të kryejnë simulimin.

¹ Shih Fletë pune “Parashikimi”




Udhëzime të rëndësishme

Dritarja


- “**Sedentare deri në Shumë aktive**”.
- “**Vetëm sedentare**”: Do të thotë që gjatë gjithë ditës rrini ulur duke u shlodhur. Gjatë ditës ecni shumë pak.
- “**Sedentare**”: Lëvizni vetëm për aktivitetin e përditshëm. Në pjesën më të madhe të ditës rrini ulur.
- “**Aktivitet i moderuar**”: Gjatë një pjese të mirë të ditës jeni në lëvizje. Lëvizni në këmbë për të shkuar në shkollë apo në vende të ndryshme gjatë ditës.
- “**Shumë aktiv**”: Gjatë gjithë kohës jeni në lëvizje. Në pjesën më të madhe të ditës kryeni aktivitete të ndryshme fizike. Veprimtaritë ditore kërkojnë sforcime jo shumë të mëdha fizike.
 - Shtylla “**Forca e zemrës**”: Varet nga ushtrimet fizike që kryen një individ gjatë ditës dhe është e pavarur nga sasia e yndyrave në trup.

- Shtylla “**Sforcimi i zemrës**”: Sforcimi i zemrës varet nga sasia e yndyrave në trup. Si vlerat shumë të ulëta ashtu edhe ato shumë të larta të yndyrave e sforcojnë zemrën. Kjo nuk varet nga ushtrimet fizike.
- Fushat “**Mashkull; Femër**”: Meshkujt dhe femrat paraqesin vlera të ndryshme për shkak të niveleve të ndryshme të yndyrave në trup dhe harxhimit të ndryshëm të kalorive.


Për simulimin nxënësit ndahen në grupe dyshe, një vajzë dhe një djalë. Çdo grup do ta kryejë simulimin fillimisht duke zgjedhur “femër”. Secila vajzë e grupit do të zgjedhë në simulim dietën e saj, duke mbajtur te “Sedentare”. Vëzhgoni në simulim sforcimin e zemrës dhe forcën e zemrës.



Pas një viti çfarë ndodh me “Forca e zemrës”?




Ndryshojmë nga “Sedentary” në “Moderate Activity”. çfarë ndodh me “Forca e zemrës”?





Vëzhgoni ndryshimet në grafik. Në çfarë përfundimi arrini?

Tashmë kaloni në opsionin “Very Active”. Çfarë ndodhë me “Forca e zemrës”?



Vëzhgoni ndryshimet në grafik. Në çfarë përfundimi arrini?

Çfarë duhet të ndryshoni në stilin tuaj të jetesës që “Forca e zemrës” të hyjë në zonën e gjelbër që nënkupton zemër të shëndetshme? Parashikoni si duhet të jetë dieta juaj dhe veprimtaria fizike për një zemër të shëndetshme.



A është ky një stil jete i shëndetshëm? Argumentoni përgjigjen tuaj.



Përforcimi: Koha e pritjes- Nxënësit punojnë me fletën e punës ²me situata nga jeta reale dhe më pas diskutojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre .

Vlerësimi i nxënësit sipas niveleve të arritjes për temën mësimore.

Bën parashikime dhe i shqyrton ato me anë të provave:

N2: Tregon se ka një lidhje ndërmjet ritmit të rrahjeve të zemrës, dietës ushqimore dhe veprimtarisë fizike pa dhënë shpjegime shkencore;

N3: Analizon lidhjen ndërmjet ritmit të rrahjeve të zemrës, dietës ushqimore dhe veprimtarisë fizike;

N4: Bën parashikime si duhet të jetë dieta ushqimore dhe veprimtaria fizike për një zemër të shëndetshme dhe i shqyrton me anë të provave.

Interpreton të dhënat duke nxjerrë përfundime për lidhjen ndërmjet ritmit të zemrës dhe sasisë së oksigjenit në gjak:

N2: Përshkruan të dhënat e grafikut por nuk identifikon tendencat;

N3: Shpjegon nga të dhënat e grafikut lidhjen ndërmjet ritmit të rrahjeve të zemrës dhe sasisë së oksigjenit në gjak;

N4: Interpreton të dhënat duke nxjerrë përfundime për lidhjen ndërmjet ritmit të zemrës dhe sasisë së oksigjenit në gjak.

² Shih fletë pune: Përforcimi

B. Model ore mësimore 2 në lëndën e “Biologjisë” AML

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: Acidet nukleike dhe sinteza e proteinave	Situata e të nxënit: Fabrika kimike e proteinave në të ardhmen? <i>Inxhinieria gjenetike ka arritur që të modifikojë organizma të tillë si bakteret për të prodhuar proteina. Baktere të tilla si E.coli modifikohen për të prodhuar aminoacide të ndryshme jonatyrore. Kjo do të thotë se këto baktere mund të prodhojnë proteina të reja specifike, me veti të veçanta e të dobishme për ne. Fakti që aminoacidet e reja nuk gjenden në natyrë, do të thotë se këto baktere të modifikuara mund t'i prodhojnë proteinat e reja vetëm në kushte laboratorike, ku edhe mund të furnizohen me këto aminoacide. Nëse dalin nga laboratorët, ato nuk do të mbijetojnë në mjedis. Në të ardhmen, “Kimia e proteinave” do të jetë shumë e ndryshme nga sot. POR si sintetizohen proteinat në sistemet biologjike? Çfarë rëndësie të kuptuarit e këtij procesi në përmirësimin e jetës dhe shëndetit të njeriut?</i>		
Tema mësimore: Sinteza e proteinave		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkenca natyrore, TIK.	
Rezultatet e të nxënit për temën mësimore Nxënësi: • skematizon procesin e biosintezës së proteinave; • vlerëson rëndësinë e të kuptuarit të biosintezës së proteinave në përmirësimin e jetës dhe shëndetit të njeriut.			
Burimet: libri i nxënësit, mjete shkrimi, fletë të bardha për skicimin e proceseve dhe koncepteve, tabela ilustruese, flipchart, lapustila, simulime, animime, fletë pune,		Koncepte kyç: kromozom, ADN, gjen, mARN, ARN polimeraza, ribozome ARN-t, citoplazmë, aminoacide, kod gjenetik etj.	

laptop, projektor, dërrasa e zezë, shkumësa me ngjyra etj.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

PNP: Parashikimi (15'); Ndërtimi i njohurive (20'); Përforcimi (10')

Strategjitë e përdorura: Koha e pritjes, Simulimi, One minut paper.

Organizimi i orës së mësimi

Parashikimi (15'): *Strategjia e përdorur- Koha e pritjes* - Fillimisht pyeten nxënësit se çfarë janë proteinat dhe cilët janë monomerë të tyre. Në cilin organel qelizor ndodh sinteza e proteinave? Çfarë janë acidet nukleike? Cili është dallimi midis kromozomit, ADN-së dhe gjenit. Cilat janë funksionet e mARN, ARN-r, ARN-t. Nxënësit lejohen 5-10 sekonda t'u përgjigjen pyetjeve. Referuar situatës së të nxënit që ju është prezantuar nxënësve në fillim të kapitullit theksohet se kuptimi i sintezës së proteinave është thelbësor në studimin e inxhinierisë gjenetike dhe fushave të ndryshme të mjekësisë. POR si sintetizohen proteinat në sistemet biologjike? Çfarë rëndësie ka njohja dhe të kuptuarit e këtij procesi në përmirësimin e jetës dhe shëndetit të njeriut?

Ndërtimi i njohurive (20'): *Strategjia e përdorur- Simulimi*-. Nxënësit ndërtojnë njohuritë e reja mbi biosintezën e proteinave duke realizuar një simulim.

Fillimisht nxënësve ju përshkruhet biosinteza e proteinave si procesi i formimit dhe organizmit të proteinave në qelizë. Ky proces kalon në dy faza kryesore që janë: transkriptimi dhe translatimi. Transkriptim do të thotë kopjim, dhe translatim do të thotë përkthim. Pas këtij përshkrimi të shkurtër nxënësit punojnë në linkun:

https://labbxchange.org/library/items/lb:LabXchange:fb468b9e:lx_simulation:1

Për të realizuar simulimin, nxënësit duhet të ndjekin udhëzimet pasi futen në link. Fillimisht nxënësit duhet të klikojnë butonin e transkriptimit hap pas hapi. Simulimi tregon qelizën, më pas bërthamën e qelizës ku paraqiten kromozomet → kromatina → ADN → ardhja e ARN polimerazës → këputja e lidhjeve hidrogjenore → fillimi i sintezës së mARN-së. Në simulim tregohet se si për shkak të vetisë së përplotësimit krijohet vargu i mARN. Këtu ndalohe

simulimi dhe pyeten nxënësit se cili është nukleotidi që vendoset në mARN kur në gjen ndodhet Adenina? Pas përfundimit të simulimit të transkriptimit kërkohet që nxënësit të shpjegojnë me fjalët e tyre procesin e transkriptimit. Drejtohen pyetje të tilla si: Ku ndodh transkriptimi? Cilat janë strukturat që marrin pjesë në transkriptim? Pas qartësimit të transkriptimit kërkohet nga nxënësit që të bëjnë simulimin e translatimit. Në simulim tregohet mARN e transkriptuar e cila takon ribozomin. Fillon faza e sintezës së vargut polipeptidik. Në simulim tregohet ARN-t që sjell aminoacidin metioninë. Pas fiksimit të saj në qendrën P dy nënnjësitë e ribozomit rrëshqasin dhe tregohet ardhja e ARN-t që sjell prolinën. Në simulim tregohet qartë përputhja e kodonit me antikodonin. Pasi prolina lidhet me metioninën largohet ARN-t që solli metioninën. Ribozomi rrëshqet për të lexuar tripletin e radhës. Kështu vazhdon në simulim zgjatja e vargut polipeptidik. Në fund ribozomi lexon tripletin UAG që mbart mesazhin STOP. Në simulim paraqitet largimi i dy nënnjësjve të ribozomit, largimi i mARN dhe dalja e lirë e vargut polipeptidik me 11 aminoacide. Pas përfundimit të simulimit të translatimit u kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalët e tyre procesin e translatimit. Edhe gjatë kësaj faze u drejtohen pyetje të tilla si: Ku ndodh translatimi? Cilat janë strukturat që marrin pjesë në translatim?

Vazhdohet me simulimin duke u kërkuar nxënësve të bëjnë ndryshim në renditjen e nukleotideve në gjen duke klikuar butonin “Edit DNA”. Aty duhet të ndryshojnë nukleotidet në dy prej tripleteve. Pas kësaj kryejnë simulimin e translatimit të vargut të ri të ADN. U kërkohet nxënësve të bëjnë krahasimin e dy vargjeve polipeptidike të translatuara.

Përforcimi i njohurive (10’): Strategjia e përdorur- One minut paper- në këtë etapë të orës së mësimi nxënësit do të zhvillojnë kuicin interaktiv në classroom.(Shih shtojcën fq.35).

Vlerësimi i nxënësit referuar niveleve të arritjes

Nivelet e arritjes për rezultatin e të nxënësit: **Skematizon procesin e biosintezës së proteinave.**

- N2-Përshkruan nëpërmjet simulimit biosintezën e proteinave;
- N3- Analizon fazat kryesore të biosintezës së proteinave;
- N4-Skematizon procesin e biosintezës së proteinave.

Nivelet e arritjes për rezultatin e të nxënësit: **Vlerëson rëndësinë e të kuptuarit të biosintezës së proteinave në përmirësimin e jetës dhe shëndetit të njeriut.**

- N2- Tregon se proteinat mund të sintetizohen dhe në kushte laboratorike “fabrika kimike” për të përmirësuar jetën dhe shëndetin e njeriut;
- N3- Shpjegon përmes shembujve se prodhimi i proteinave në “fabrika kimike” përmirëson jetën dhe shëndetin e njeriut;
- N4- Vlerëson rëndësinë e të kuptuarit të biosintezës së proteinave në përmirësimin e jetës dhe shëndetit të njeriut.


←**Detyrat dhe puna e pavarur:** Jepet renditja e nukleotideve në një segment ADN-je.

AATTCCTTAAAGGCCGTCAGCTTTAACTTC

- a) Shkruani mARN që transkriptohet nga ky varg
- b) Duke përdorur tabelën e kodit gjenetik përcaktoni vargun polipeptidik që translatohet?

SHTOJCA

1. SCREENSHOOT-et E SIMULIMIT



[Share](#) [About](#)

LabXchange

Share About



LabXchange®

Share About



[< DNA to Protein](#)

LabXchange

C
Share
About

Click [Transcribe](#) to see full mRNA strand created or [Transcribe step by step](#)

Click [Translate](#) to generate full protein from mRNA or [Translate step by step](#)

[Start/continue model](#)
[Stop](#)
[Reset](#)
[Edit DNA](#)

[<< Jump](#)
[Continue one step](#)
[Jump >>](#)

[< DNA to Protein](#)

LabXchange

C
Share
About

Click [Transcribe](#) to see full mRNA strand created or [Transcribe step by step](#)


Click [Translate](#) to generate full protein from mRNA or [Translate step by step](#)

[Start/continue model](#)
[Stop](#)
[Reset](#)
[Edit DNA](#)

[<< Jump](#)
[Continue one step](#)
[Jump >>](#)



2. SCREENSHOOT-e TË KUICIT INTERAKTIV



Procesi i transkriptimit ndodh në bërthamën e qelizës




Si quhet enzima që merr pjesë në transkriptim?


- A- mARN
- B- ARN polimeraza
- C- ADNpolimeraza




Enzima që merr pjesë në transkriptim quhet ARN polimeraza



Kodi gjenetik përcaktohet nga:
A- renditjet dyshe të nukleotideve të ADN-së
B- renditjet treshe të nukleotideve ADN-së
C- renditjet e aminoacideve në vargun polipeptidik të një proteine



Kodi gjenetik përcaktohet nga renditjet treshe te nukleotideve te ADN-së



Shihni pjesën e një molekule të ARN-së mesazhere dhe gjeni:


AUGACGCAUGCAGUCCGA


Sa aminoacide përmban proteina e translatuar?

A- 6

B-9

C-18





Gjatë translatimit në ribozome aminoacidet lidhen me lidhje peptidike

Shko tek pyetja 6

Shumë nga sëmundjet metabolike lidhen me mungesën e prodhimit të një enzime të caktuar. Referuar edhe situatës së të nxënit ku qëndron rëndësia e njohjes dhe të kuptuarit të biosintezës së proteinave?

A- Kjo na lejon që të prodhojmë proteina ushqyese të rëndësishme për dietën tonë ushqimore

B- Prodhimi i proteinave në fabrikat kimike do të ndikojë në përmirësimin dhe rritjen e të ardhurave ekonomike në shkallë globale.

C- Prodhimi i një proteine të re në fabrikat kimike do të përmirësojë jetën e individëve që vuajnë nga sëmundje të tilla.

- Prodhimi i këtyre enzimave në fabrikat kimike të prodhimit të proteinave do të përmirësojë jetën e individëve që vuajnë nga sëmundje të tilla metabolike.
- Mund të prodhohen proteina që duke u injektuar në gjak të mos shkaktojnë reaksione alergjike.
- Këto enzima mund të kenë gjysëmjetë më të gjatë se enzima natyrore

Përfundo kuicin

Ju e përfunduat kuicin

FALEMINDERIT!

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore

Gjithsej 30 pikë

Përshkruesit	Niveli 1 - <i>Dobët</i>	Niveli 2 – <i>Mjaftueshëm</i>	Niveli 3 – <i>Mirë</i>	Niveli 4 – <i>Shumë mirë</i>
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës.	Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në programin lëndor. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënës. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënës (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënës. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënës. Pyetjet në përgjithësi	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodatat dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënës dhe me stilet e të nxënës. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënës, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.

	<i>niveleve të ndryshme.</i>	<i>janë sipas niveleve.</i>	<i>të ndryshme sipas niveleve.</i>	
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>

Mjedisi i të nxënit (6 pikë)

Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të</i>
--	--	---	---	--

mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>

	<i>vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>gjithëve marrin një përgjigje.</i>	<i>gjithëve marrin një përgjigje.</i>	
--	---	---------------------------------------	---------------------------------------	--

Metodat mësimore (6 pikë)

	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u përqendruar më së shumti te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këtë metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimit, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehjet e mendimit kritik.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknikë që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këtë metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumë llojshmëri të metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknikë që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, që nxitin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.				

	<i>shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>			
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</i>

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në</i>
---	---	---	---	---

procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>mësimi. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi e përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën mësimi. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën mësimi, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit</i>

sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.	<i>marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
---	--	---	---	---

Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)

Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbytje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbytje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te ata të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbytje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbytje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbytje të rezultateve të të nxënit të temës</i>

			<i>përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>
--	--	--	-----------------------------	--

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular

Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognjitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular merr parasysh njohuritë paraprake të nxënësit.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*



Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

A. Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: "Mikroorganizmat"

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 9 orë mësimore (të planifikuara 3 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa VII

Qëllimi i projektit: Ky projekt ka për qëllim të zhvillojë te nxënësit aftësitë e kërkimit shkencor duke i inkurajuar ata të eksplorojnë në mënyrë aktive mbi rëndësinë e mikroorganizmave në natyrë dhe në jetën e njeriut.

Rezultatet e të nxënësit:

Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi:

- Eksploron dhe diskuton rolin e mikroorganizmave në natyrë dhe në jetën e njeriut.
- Hulumton për lloje të ndryshme mikroorganizmash dhe karakteristikat e tyre.
- Planifikon dhe kryen eksperimente për të studiuar mikroorganizmat në kushte të ndryshme.
- Analizon të dhënat e mbledhura nga eksperimente dhe nxjerr përfundime.
- Diskuton rëndësinë e mikroorganizmave në kërkime shkencore.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Mikroorganizmat, bakteret, viruset, kërpudhat, protozoarët;
- Grumbullimi i të dhënave, vëzhgimi dhe eksperimentimi;
- Analiza dhe interpretimi i rezultateve;
- Përdorimi i grafikëve dhe tabelave për të paraqitur informacionin;
- Diskutimi dhe reflektimi mbi rezultatet hulumtuese.

Partnerët që do të marrin pjesë në projekt:

mësues,

prindër,

nxënës,

ekspertë të fushës.

Burimet kryesore të informacionit:

- Teksti mësimor i biologjisë për klasën e VII;
- Materiale nga interneti të ofruara nga burime të besueshme që ofrojnë informacion mbi mikroorganizmat;
- Takim me ekspertin të fushës së mikrobiologjisë
- Eksperimente të realizuara në klasë.
- Etj.

Tematika e orëve të planifikuara:

- ***Ora 1:***Diskutim me nxënësit lidhur me temën e projektit. Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit. Ndarja e klasës në grupe. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës. Ftohen nxënësit të kryejnë kërkime për të mbledhur të dhëna dhe informacione përkatëse rreth çështjes që do hulumtojnë në grupet përkatëse. Përcaktohet një ekspert në fushën e mikrobiologjisë për të mbajtur një prezantim për nxënësit.
- ***Ora 2:***. Zhvillimi i takimit me ekspertin në fushën e mikrobiologjisë.
- ***Ora 3:*** Sesione diskutimi me nxënësit për raste të njohura të mikroorganizmave, si shpërthimet epidemike të sëmundjeve dhe rëndësinë e vaksinave dhe higjienës, rëndësinë e mikroorganizmave në kërkime shkencore etj.
- ***Ora 4:*** Eksperimente praktike në klasë për të vëzhguar mikroorganizmat.
- ***Ora 5:*** Analiza e të dhënave të mbledhura nga eksperimentet dhe burimet e tjera. Përpunimi i materialit të grumbulluar.

- **Ora 6:** Hartimi i draftit të parë të projektit, ku përfshihen rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi i tyre.
- **Ora 7:** Hartimi i draftit përfundimtar të projektit ku përfshihen rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi i tyre.
- **Ora 8:** Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.
- **Ora 9:** Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit. Prezantohen nxënësit me aspekte të ndryshme që lidhen me llojet e mikroorganizmave (bakteret, viruset, kërpudhat dhe protozoarët) dhe rëndësinë e tyre si: a) në bioteknologji për prodhimin e ilaçeve, vaksinave, dhe në procese të ndryshme industriale si fermentimi (p.sh., prodhimi i birrës, bukës, djathit etj.), b) në riciklimin e lëndës, shpërbërjen e mbetjeve dhe në shëndetin e ekosistemeve, c) në shëndetin e njeriut, p.sh. mikroorganizmat që jetojnë në trupin e njeriut, sidomos në zorrë, ndihmojnë në tretjen e ushqimit dhe në absorbimin e nutrientëve, mbrojtjen ndaj patogjenëve, prodhimin e vitamina të rëndësishme, si vitamina K dhe disa vitamina B d) në kërkime shkencore, studimi i mikroorganizmave ndihmon në kuptimin e sëmundjeve infektive dhe në zhvillimin e terapive të reja. Kërkojuni nxënësve të zgjedhin një nga çështjet e diskutuara dhe të kryejnë kërkime për të mbledhur të dhëna dhe informacione përkatëse rreth çështjes. Mund të kërkohen tema të tjera të sugjeruara nga nxënësit. Ndahet klasa në grupe sipas interesave të nxënësve. Ndahen detyrat për secilin nxënës brenda grupit (kërkuesit ose eksperimentuesit, analizuesit, komunikuesit, menaxheri që organizon punën e grupit dhe siguron që cdo anëtar të kontribuojë).
- Udhëzohen nxënësit për metodat e mbledhjes së të dhënave, Ata udhëzohen gjithashtu të marrin parasysh kërkimin e burimeve shkencore që lidhen me temën e zgjedhur. Përcaktohet eksperti shëndetësor që do të ftohet për të bërë prezantimin me nxënësit.
- Takimi me ekspertin në fushën e mikrobiologjisë për të diskutuar rreth hulumtimeve të fundit dhe aplikimeve të mikroorganizmave në bujqësi, ndikimi në shëndet apo përdorimi në industri.
- Planifikimi dhe kryerja e eksperimenteve për të studiuar mikroorganizmat në kushte të ndryshme të tilla si:

- vëzhgimi i rritjes së mikroorganizmave në kushte të ndryshme (temperatura, pH, etj.);
- fermentimi i sheqernave për të prodhuar produkte si kos, bukë etj.;
- përgatiten mostrat, përdoren teknikat e sterilizimit, maten rezultatet.
- Analizohen të dhënat e mbledhura nga eksperimentet dhe burime të tjera. Ndërtohen grafikë dhe tabela për të interpretuar rezultatet dhe përgatitur raportet analitike. Përdoren të dhëna statistikore për analizimin e të dhënave (nëse është e nevojshme).
- Hartimi i projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale. Inkurajohen nxënësit të krijojnë paraqitje vizuale të të dhënave të tyre, për të komunikuar në mënyrë efektive gjetjet e tyre.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit. Nxënësit përgatisin prezantime për të ndarë kërkimet e tyre, analizën e të dhënave dhe përfundimet me klasën ose një audiencë më të gjerë, si p.sh. me mësuesit dhe prindërit.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë produktet.
- Nxiten nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Projekti do të përfshijë krijimin e një broshure informuese që paraqet të dhënat e mbledhura, gjetjet mbi rëndësinë e mikroorganizmave. Nxënësit do të inkurajohen të krijojnë gjithashtu një panel informativ që mund të ekspozohet në shkollë për të rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit nga mikroorganizmat.

Nxënësit mund të krijojnë një platformë online për të ndarë gjetjet e tyre, eksperimente, artikuj dhe video edukative mbi mikroorganizmat.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi do të bazohet në kritere të tilla si:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e hulumtimit për mikroorganizmin e zgjedhur.
- ***Analiza dhe interpretimi i të dhënave:*** Saktësia dhe përdorimi efektiv i teknikave për analizimin e rezultateve.

- 
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Efikasiteti dhe qartësia gjatë paraqitjes përfundimtare.
 - ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Vlerësimi i gjetjeve dhe reflektimi mbi punën e kryer.

B. Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: Riciklimi

Kohëzgjatja: 9 orë (3 orë për çdo periudhë mësimore)

Klasa: Klasa e X ose XI-të

Qëllimi i projektit: Ky projekt ka për qëllim të ndihmojë në promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore, reduktimin e mbetjeve dhe zbulimin e rëndësisë së ruajtjes së burimeve natyrore.

Rezultatet e të nxënit:

- Diskuton rëndësinë e riciklimit për mjedisin dhe shëndetin publik.
- Identifikon llojet e materialeve që mund të riciklohen dhe procesin e riciklimit.
- Zhvillon aftësi për të mbledhur dhe analizuar të dhëna përmes anketave dhe intervistave.
- Nxit bashkëpunimin dhe angazhimin e komunitetit në aktivitete riciklimi, duke organizuar ngjarje dhe aktivitete të tjera që inkurajojnë pjesëmarrjen aktive.
- Krijon një produkt final që ilustron propozime për përmirësimin e praktikave të riciklimit në nivelin lokal.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:


- Riciklimi
- Menaxhimi i mbetjeve
- Qëndrueshmëria
- Përdorimi i burimeve natyrore
- Ndikimi mjedisor

Partnerët:

Organizatat joqeveritare të mjedisit

Autoritetet lokale (bashkia)

Nxënësit dhe familjet e tyre si target për anketim



Burimet kryesore të informacionit:

- Anketë për banorët e zonës dhe nxënësit rreth praktikave të riciklimit.
- Intervista me ekspertë të menaxhimit të mbetjeve dhe aktivistë të mjedisit.
- Pyetësorë për nxënësit dhe familjet e tyre.
- Materiale nga interneti (artikuj, studime, video).

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- **Ora 1:** Prezantimi i temës së riciklimit, rëndësia dhe përfitimet për mjedisin. Diskutimi mbi llojet e materialeve që riciklohen (papërshkueshmëria, alumini, plastika, etj.) dhe procesin e riciklimit.
- **Ora 2:** Hartimi i anketave për të mbledhur informacione mbi njohuritë dhe praktikën e riciklimit mes banorëve. Praktikim për mënyrën e formulimit të pyetjeve dhe intervistave.
- **Ora 3:** Mbledhja e të dhënave përmes anketave dhe intervistave. Diskutimi mbi përvojat e hasura gjatë procesit dhe përpunimi i gjetjeve.
- **Ora 4:** Analiza e të dhënave të mbledhura dhe identifikimi i mangësive në praktikën e riciklimit në komunitet.
- **Ora 5:** Takime me përfaqësues nga autoriteti lokal ose organizata ambientaliste për diskutimin e zgjidhjeve.
- **Ora 6:** Krijimi i draftit të parë të produkteve të projektit (prezantim, poster, video) që shqyrton gjetjet dhe ofron propozime për përmirësimin e praktikave të riciklimit.
- **Ora 7:** Hartimi i draftit përfundimtar të projektit dhe diskutimi i tij.
- **Ora 8:** Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.
- **Ora 9:** Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Diskutime në grup mbi rëndësinë e riciklimit dhe ndikimin e tij në mjedis, llojet e materialeve që riciklohen, procesin e riciklimit etj..
- Mbledhje të të dhënave përmes anketave dhe intervistave.
- Organizim i takimeve me përfaqësues nga autoriteti lokal ose organizata ambientaliste.

- Analizë dhe përpunim i informacionit të grumbulluar.
- Krijimi dhe prezantimi i produktit përfundimtar.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Projekti do të përfshijë:

- Hartimin e një raporti të detajuar mbi njohuritë dhe praktikën e riciklimit në komunitet, përfshirë gjetjet nga anketat dhe intervistat.
- Prezantim (poster dhe PowerPoint) që ilustron gjetjet, propozimet dhe rekomandimet për rritjen e normave të riciklimit.
- Përgatitjen e një video të shkurtër që shpreh rëndësinë e riciklimit dhe ndikimin e tij në mjedisin e përbashkët për të rritur ndërgjegjësimin në komunitet dhe inkurajuar komunitetin për të kontribuar.
- Ndërmarrje e veprimeve konkrete për të kontribuar me riciklimin në komunitetin ku shkolla funksionon me mbështetjen e organizatave joqeveritare të mjedisit dhe/ose autoriteteve lokale.

(P.sh. Të krijohen dhe të implementohen programe specifike për grumbullimin dhe riciklimin e materialeve të caktuara, si bateritë, pajisjet elektronike dhe mbetjet organike etj.. Të sigurohen vendstrehime dhe pika grumbullimi për materialet e riciklueshme, për të lehtësuar procesin e riciklimit për qytetarët).

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:


- *Aftësitë kërkimore/hulumtuese:* Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer për praktikën e riciklimit dhe mbrojtjen e ambientit përmes riciklimit.
- *Analiza dhe interpretimi i të dhënave:* Saktësia dhe përshtatshmëria e teknikave të përdorura për të analizuar të dhënat e mbledhura.
- *Aftësitë e prezantimit:* Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar dhe videos.
- *Mendimi kritik dhe reflektimi:* Thellësia e analizës, vlerësimi i zgjidhjeve të mundshme dhe reflektimi mbi veprimet e ndërmarra.
- *Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit:* Individualisht dhe në progresin e grupit.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – <i>Dobët</i>	Niveli 2 – <i>Mjaftueshëm</i>	Niveli 3 – <i>Mirë</i>	Niveli 4 – <i>Shumë mirë</i>
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/ hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë	3-5 pikë Nxënësit ndonjëherë	6-8 pikë Nxënësit zakonisht	9-10 pikë Nxënësit përdorin gjatë gjithë

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre.</i> <i>Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

